

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KLENER" SH.P.K.

Sot me datë 23.03.2023, bazuar në vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", personat e poshteshnuar:

1. Fitneda Kasa, e bija e Niko, lindur me 09.05.1992, lindur ne Lushnje dhe banues në Tirane, në adresën Rruga M.Grameno, hyrja 2, ap.22., madhore me zotësi të plotë për të vepruar, me numer personal J25509098B, mbajtese e kartes se identitetit me Nr. 037711464 leshuar nga Republika e Shqiperise.
2. Remila Oga, e bija e Josifit, lindur me 01.06.1977, lindur ne Shkoder dhe banues në Tirane, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, me numer personal H75601079H, mbajtese e kartes se identitetit me Nr.035121462 leshuar nga Republika e Shqiperise.
3. Kleves Ullorja, i biri i Nazmiut, lindur me 13.04.1976, lindur ne Elbasan dhe banues në Elbasan, në adresën Rruga Rinia, Elbasan, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer personal H60413088D, mbajtes I pasaportes me Nr. BC3000527 leshuar nga Republika e Shqiperise.

Që në vijim do të quhen "Ortakë", vendosen të themelojnë shoqerine "KLENER" SH.P.K (qe me poshte do te referohet si "Shoqeria") dhe të hartojnë Statutin e shoqërisë.

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë QKR sipas parashikuimeve të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 1

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqeria ka si objekt kryerjen e te gjitha aktivitetave qe një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, perfshire por pa u kufizuar në fushen e mjekësise dhe shendetit ne perputhje me autorizimet dhe akreditimet publike te parashikuara nga legjislacioni shqiptar, si me poshte vijojne, por pa u kufizuar vetem ne to: Ne fushen e mjekësise dhe shendetit: a) Ofrimin e sherbiimeve mjekesore dhe spitalore (edhe spitaleve ditore) jopublike. Laborator mjekesor. Ambulator mjekesor. Sherbim urgjence spitalore me ambulance private. Diagnostikim mjekesor dhe kirurgjikal. b) Ofrimin e sherbimit te trajtimeve estetike, nderhyrjeve, kirurgjise, mjekësise estetike (rinoplastike, blefaroplastike, otoplastike, lifting i ftyres, rimodelim i mjekres, liposukcion, lifting i kraheve, rimodelim i barkut, riperteritje te lekures, trapiant i vetullave, kirurgji rikonstruktive, transplant i flokeve, lifting i gjoksit, zmadhim ose zvogelim i gjoksit, gjinekomasti, liposkulpture, trajtime me lazer, botox per rrudhat, rimodelim i buzeve, xantelazma hark plazmatik, trajtim me multivitamina, qepallat hark plazmatik, lifting i vetullave botox, rimodelim i 2 mollezave, mikrodermoabrazion, jawline contouring, filler per rrudhat, PRP per ftyren dhe per floket, rrathet e syve, white peeling, gummy smile, microneedling, radiofrekuencia, trajtimi i bruksizmit, mbushja e sulkuseve, trajtim celluliti, hark plazmatik, karboksiterapi, heqje tatuazhi, skleroterapi, hiperhidroze, lipolize etj.); c) Sipermarrja dhe sherbimi ne fushen e mjekësise, kirurgjive te ndryshme, ngritja e qendrave te ndryshme laboratorike dhe/ose ekzaminuese, qendrave estetike, klinikave, spitaleve etj.; d) Furnizimin dhe ofrimin e sherbimeve laboratorike, klinike, biokimike, mikrobiologjike, gjenetike etj.

e) Importin, eksportin dhe tregtimin me shumice dhe/ose me pakice te produkteve mjekesore apo farmaceutike, ushqimore, industriale, produkteve kozmetike, si dhe te pajisjeve mjekesore dhe/ose shendetesore; f) Furnizimin dhe ofrimin e sherbimeve te mirembajtjes se pajisjeve shendetesore; g) Ofirim e sherbimeve te ndermjetesimit ne fushen e shendetesise, nepermjet kontaktimit dhe/ ose te kontraktimit me profesionistet me te mire te kirurgjise estetike per llogari te pacienteve/klienteve. h) Menaxhimin dhe/ose ndertimin e shtepive te perkujdesjes ne territorin e Republikes se Shqiperise per pritjen e te semureve nepermjet ambulatoreve te vet, te specialitetave te ndryshme, pensioneve, si dhe te aktivitetave te tjera plotesuese, te lidhura ose te ngashme me kete; i) k) Menaxhimin e sherbimeve plotesuese per veprimtarite e mesiperme si per shembull: sherbime restoranti, sherbime farmaceutike, sherbime te pastrimit, mbledhjes dhe transformimit te mbetjeve etj.; l) Furnizimin e sherbimeve te konsulences ne fushen e mjekesise dhe shendetit; m) Kryerjen e veprimtarive te publikimit dhe reklamimit ne fushen e mjekesise dhe shendetit; n) Shitjen online te produkteve dhe sherbimeve qe Shoqeria ofron ne fushen e mjekesise dhe shendetit, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari tjeter qe, edhe pse nuk ka lidhje me sa eshte parashikuar me siper, nuk perben nje veprimtari te ndaluar me ligj dhe qe eshte ne funksion te perm bushjes se objektit te Shoqerise.

Neni 2

Emërtimi dhe Selia e Shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është "KLENER", i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca "SH.P.K", që përfaqëson formën juridike të saj.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Ruga "Ibrahim Rugova", Tirana.kompleksi green park, kulla 2 hyrja 1 ap39

Shoqëria mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi, degë dhe angjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Regjimi juridik

Shoqëria është person juridik shqiptar, ka formën ligjore të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje më ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Veprimtaria e saj i nënshtronet dispozitave të këtij Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Me vendim të sajin, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme përfunksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast, Ortakët duhet të përshtatin Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e tij në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

Shoqëria gjëzon personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Neni 4

Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve

Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje, të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria gjëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak ose aksionar në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj të nënshkruar dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet përfetyrimet e ortakëve dhe as këta të fundit nuk mbajnë përgjegjësi personale përfetyrimet që merr përsipër shoqëria.

Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Statutin, dhe legjislacionin në fuqi vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

2 | Faqe

Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë. Për këtë gjëzon të drejtën që të caktojë një person të emëruar prej tij që të marrë këtë informacion. Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributave të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqeria ë zhvillon aktivitetin e saj per një kohe te pa percaktuar.

Neni 6
Kapitali i shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte i barabarte me 100(njeqind) lekë. Kapitali i regjistruar eshte plotësisht i nenshkruar dhe i ndare ne 3 kuota, te zotruara nga ortaket, perkatesisht si me poshte :

1. Fitneda Kasa, e bija e Niko, lindur me 09.05.1992, zoteruese e një kuote me vlerë 34 leke
2. Remila Oga, e bija e Josifit, lindur me 01.06.1977, zoteruese e një kuote me vlerë 33 leke
3. Kleves Ullorja, i biri i Nazmiut, lindur me 13.04.1976., zoterues I një kuote me vlerë 33 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve dori në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund të Zmadhohet ose te zvogëlohet në çdo moment me vendim te asambleja e per gjithshme e ortakeve, në përputhje me dispozitat e n.9901 ligjit 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Në çdo rast, kapitali i regjistruar nuk mund te zvogelohet në kufirin minimal te paraqituar nga ligji.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9
E drejta e prablerjes se ortakeve

Shitja e pjeseshme e kuotave nga ortaku mund te behet vetem ndaj ortakeve te tjere dhe jo ndaj personave te trete.

Ne rastin kur njeri nga ortaket kerkon te shese te tere kuoten, ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes. Ortaku qe kerkon te shese kuoten njofton ortaket e te tjere me shkrim. Nga momenti i njoftimit ortaket kane detyrimin qe brenda nje afati kohor dy favor te perqigjen per kerkeses per blerjen e kuotes. Ortaket mund te bien dakord me ane te nje marreveshje te hartuar para nje noteri qe pagesa te behet brenda nje afati 30 ditor nga momenti i pranimit te kerkeses per blerjen e kuotes.

Ne rastin e blerjes se kuotes nga ortaket behet vleresimi i biznesit me keto kushte:

Mblidhet pjesa e investimit fillestar e shvleresuar 7% cdo vit me dividentin e viti te meparshem.

Ne pese vitet e fundit te kontrates shuma e dividentit do te skontohet si me poshte:

Viti 7: me 20%

Viti 8-te : me 40%

Viti 9-te : me 60%

Viti 10-te : me 80%

Viti 11-te : me 100%

Ne rastin kur asnjeri nga ortaket nuk ushtron te drejten e parablerjes, brenda afateve te sipercuruara, atehere shitja e kuotes mund te kryhet ndaj nje personi te trete.

Neni 10
Drejtimi dhe Organet Kryesore

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj.

Emertimi i Shoqerise Tregtare, kapitali themeltar, duhet te jenë te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxjerr kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te tretave.

Organet kryesore te Shoqerise janë:

- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori;
- eventualisht Eksperti Kontabel i Autorizuar.

Neni 11
Asambleja e Ortakeve te shoqerise

Asambleja e Ortakeve eshtë organi me i lartë vendimmarrës i shoqerise dhe vendimet e saj janë te detyrueshme.

Të drejtë e thirrjes se Asamblese e kanë Administratori, Eksperti Kontabel i Autorizuar ose nga ortakët të cilët zotërojnë të paktën 5 % e kapitalit themeltar të shoqerise.

4 | Faqe

Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblese së Ortakeve bëhet me letër rekomande të paktën 14 ditë përpala datës së mbledhjes, duke parashtruar rendin e ditës dhe dokumentacionin që do të shqyrtohet.

Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht një herë në vit dhe jo me vonë se fundi i 6-mujorit të parë.

Neni 12
Përfaqësimi në asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jetet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 13
Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë sëpërgjithshm.

Procesverbali duhet të përbajë datën e vandin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalist, rezultatet e votimit.

Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruehet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalist.

Neni 14
Të drejtat dhe detyrimet e Asambleja së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrijen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15
Administrimi

Administrator i shoqerise emerohet në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.

5 | Faqe

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.
Administrator i parë i shoqërisë është Fitneda Kasa me numer personal J25509098B, prej date
23/03/2023 deri me date 22/03/2028.

Neni 16
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë së shoqërisë tregtare;
- Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve edhe ne rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmes qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuarë.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj; autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshili këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallave. Administratori ka të gjitha kompetencat përmes të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët në përpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 17
Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, përmes shkelje të ligjeve, përmes shkelje të statutit, apo përmes kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përmes përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18-të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

6 | Page

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 18
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 19
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 20
Eksperti

Eksperti ka përdetyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së ortakëve.

7 | F a q e
GJ

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë asamblesë së ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 21

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondevit ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 22
Largimi i ortakut

Ortaket kanë te drejte te largohen duke filluar nga 1 korriku i 2017, pra dy vitet e para nuk mund te largohet asnjeri.

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet

apo nuk e njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

Neni 23

Shpérndarja ose prishja e shoqërisë

Shpérndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakëve .

Nëse Asambleja e Ortakëve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 24

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvèçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së Asamblesë së Ortakëve dhe administratorit.

Neni 25
Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 26
Përfundimi i likuidimit

Pas shpérndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 27
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërise ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 28
Ndarja

Shoqëria mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve , duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Neni 29
Shtëpërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shtërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 30
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 31
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 32
Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortaket themelues.

ORTAKET E SHOQERISE

Fitneda Kasa

Fitneda Kasa



Remila Oga

Remila Oga


Kleves Ullorja

